

Fazli HAJRIZI

DHUNA, TERRORI DHE BURGOSJET PËR MOTIVE POLITIKE NË KOSOVË GJATË VITEVE 1989-1999

Iniciativa e Institutit të Historisë në Prishtinë, Institutit të Historisë në Tiranë dhe Institutit Albanologjik në Prishtinë për organizimin e kësaj konference shkencore për të hedhin më shumë dritë në të vërtetën që lidhet me dhunën, terrorin dhe gjenocidin që është ushtruar mbi popullin tonë gjatë një periudhës 145-vjeçare, e cila ka kulmuar në dhjetëvjeçarin e fundit të shek. XX, është me vend dhe me mend. Siç dihet, në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare që u pushtua nga Serbia (1912-1915), përkatësisht Mbretëria jugosllave (1918-1941) e pastaj nga Jugosllavia socialiste (prej 1944-1999), vazhdimisht është ushtruar dhunë e terror i paparë madje edhe gjenocid mbi popullatën shqiptare, e cila në vazhdimësi ka përjetuar tragjedi të rënda: privim nga të gjitha të drejtat elementare njerëzore, burgosje, ndjekje, vrasje, djegie, mohim i kombësisë shqiptare, shpronësim, dëbim, pastrim etnik i Kosovës dhe kolonizim i saj me serbë e malazezë.

Duhet të theksojmë që në fillim se gjenocidi dhe krimet makabre serbe mbi shqiptarët ka qenë strategji e vjetër. Kështu, në çdo kohë ato (krimet e gjenocidi) janë bërë legalisht dhe në mënyrë të fshehtë, dihet, të planifikuara dhe me qëllime të caktuara. Strategjia për zhdukjen e shqiptarëve është shfaqur më e qartë që nga elaborati “Naçertania” e Ilija Garashaninit, ka vazhduar gjatë gjithë periudhës së gjysmës së dytë të shek. XIX, sidomos pas pushtimit të Kosovës dhe pjesëve të tjera të Shqipërisë për të kulmuar në dhjetëvjetëshin e fundit të shek. XX (1989-1999). Ndriçimi dhe dënimi i krimit e gjenocidit në çdo kohë, pra edhe sot në vitin 2022, është akt kulture. Nëse krimi nuk ndëshkohet, ai mund të na ndëshkojë në çdo moment, sidomos kur ngrihet në sistem, pra kur institucionalizohet. Prandaj duhet të dënohen kriminelët dhe nxitësit e tyre. Një shoqëri është demokratike aq sa ajo e lufton dhe e ndëshkon krimin e kriminelët. Kush ka qëndruar pas krimeve makabre që janë bërë mbi shqiptarët në Kosovë nga ana e Serbisë në kohë të ndryshme? Pas tyre kanë qëndruar gjithmonë Kisha Ortodokse, Akademia e Shkencave e Serbisë,

udhëheqësit shtetërorë, ata që janë në krye të policisë dhe ushtrisë etj. Pra, ushtarët, policët dhe grupet paramilitare, mercenarët, vrasësit vendorë serbë kanë qenë të frymëzuar e të nxitur nga pushteti i Beogradit, Akademia e Shkencave dhe Kisha Ortodokse Serbe kanë vepruar, si gjithmonë, me kodin e Dushanit, me të cilin dhuna, krimi, gjenocidi janë të kodifikuar.

Në këtë drejtim kanë investuar shumë për ta bindur opinionin e tyre se Kosova është mitra dhe djepi serb, prandaj vetëm serbët janë të denjë të jetojnë në të. Për çudi, edhe marrëveshjet me Turqinë për shkëmbimin e popullatës, duke i paraqitur shqiptarët myslimanë si turq, Fuqitë e Mëdha i pranuan në heshtje. Kongresi i Berlinit, Konferenca e Londrës, Konferenca e Versajës, në fund ajo e Jaltës dhe mbetja e Kosovës në Federatën Jugosllave iu ka dhënë shkas rritjes së përmasave të gjenocidit antishqiptar nga forcat e errëta serbe. Vasa Çubrilloviqi në elaboratin e tij shprehej se shqiptarët nuk janë evropianë dhe sa ata duhet të shkojnë drejt lindjes, pra të shpërngulen, sepse vetëm në këtë mënyrë shpëton kontinenti i Evropës. *“E vetmja mënyrë dhe i vetmi mjet për ta zgjidhur problemin shqiptar është forca brutale e një pushteti shtetëror të organizuar...”*.

Ai propozonte që në Kosovë të sillen sa më shumë hoxhallarë që t’i bindin shqiptarët se është më mirë në Turqi, sepse atje kanë fenë e tyre dhe *“do të hanë me lugë të dukatit”*, duke vazhduar me tej se: *“Të gjithë e dimë se popullata myslimane në përgjithësi, duke qenë naive, por edhe fanatike, shumë lehtë i nënshtrohet ndikimit, sidomos atij fetar. Me fjalë të tjera, për t’i shpërngulur shqiptarët, në radhë të parë duhet ta bëjmë për vete klerin dhe parinë e tyre që kanë ndikim, qoftë duke u dhënë para, qoftë duke iu kanosur. Sa më parë duhet gjetur agjitorë, të cilët do të agjitojnë për shpërngulje, e sidomos po që se vetë Turqia do të pajtohet të na i dërgonte”. Detyrë e agjitorëve ka qenë ta lëvdojnë Turqinë, jetën e atjeshme, të thonë se atje është parajsë, se ky këtu është vend i shkaut, i kryqit, se këtu do të bëhen shkie, do ta humbin fenë. Ata që do të shpërngulen për në Turqi, dokumentet e udhëtimit do t’i nxjerrin për një ditë, pa asnjë procedurë, biletat do të jenë me çmime të lira, madje edhe falas, transporti i valixheve deri te stacionet e trenave do të jetë falas...”*

Shqiptarët kërkonin barazi, ngritjen e statusit të autonomisë, ndërsa pushteti serb përdori të gjitha mjetet për ta likuiduar atë, duke e konsideruar “kancer në gjirin e Republikës së Serbisë”

Serbia, posa rrënoi Kushtetutën e miratuar më 28 shkurt të vitit 1974, dhe likuidimit të autonomisë së Kosovës më 23 mars 1989, që e konsideronte “kancer në gjirin e Republikës së Serbisë”, bëri organizimin e administratës kryesisht me serbë e malazezë, filloi menjëherë me zbatimin e

operacioneve ndëshkimore: të përzënies nga puna, të dëbimit nga banesat, të mbylljes së shkollave, medimeve informative (gazetave e Radiotelevizionit), institucioneve shkencore (ASHAK, IAP etj.), të dhunës, terrorit, vrasjeve, dënimeve masive nga vendi etj. Organet shtetërore provonin të përmbushnin qëllimet e tyre, që, sikurse më herët, sidomos midis luftërave botërore, nën maskën e reformës agrare dhe të kolonizimit, të realizonin politikën për shtypjen brutale të popullsisë shqiptare, mbylljen e shkollave, largimin nga puna etj., të nxiste shpërnguljen masive të shqiptarëve dhe të bëjë pastrimin etnik.

Tubimi me rastin e 600-vjetorit të Betejës së Kosovës (mars 1389 - mars 1989) i dha mundësi S. Millosheviqit që të shpалosë programin ideologjik të Serbisë, duke nxitur kështu nacionalizmin e shovinizmin serb se “Kosova është djep serb” dhe se do të jetë përgjithmonë pjesë e Serbisë. E këtë kohë sa nuk kishte filluar lufta ndëretike në Federatën jugosllave, dhe kjo gjendje kishte rritur represionin në Kosovë. Kështu, derisa në Evropën Lindore po ndihej klima demokratike, Beogradit zbatonte politikë diskriminuese ndaj shqiptarëve në Kosovë e vise tjera të Jugosllavisë, duke rrënuar të gjitha strukturat institucionale politike, ekonomike, gjyqësore, policore, shëndetësore e kulturore.¹

Popullata shqiptare duke qenë e pakënaqur, manifestonte kërkesat e saj duke demonstruar hapur në rrugë e kudo kundër pretendimeve të Serbisë se Kosova “ka qenë dhe do të mbetet pjesë e organizmit të saj”. Në maj 1990 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës doli me një Deklaratë, ku kërkohej që Kosova të shpallej “*subjekt i pavarur dhe i barabartë në Jugosllavi*”. Më 2 korrik 1990 delegatët e Kuvendit të Kosovës shpallën Deklaratën kushtetuese - “*Republikën e Kosovës brenda Federatës Jugosllave*”, me miratimin dhe shpalljen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës më 7 shtator 1990, që ishte shprehje e vullnetit mbarëpopullor. Dhuna që ndërmoi pushteti serb ndaj shqiptarëve në përgjithësi, e përkeqësoi aq shumë situatën sa i detyroi shqiptarët të organizohen, me ato mundësi që kishin, për të vendosur për fatin e tyre. Popullata shqiptare, si çdo popull në rrugën e vetëvendosjes, u tregua i vendosur dhe i pandalshëm. Me Jugosllavinë, përkatësisht me Serbinë dëshmoi se i kanë rrugët e ndara. Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, Shoqata e Shkrimtarëve, Universiteti i Prishtinës, gazetarët e të përditshmes “Rilindja”, etj., përbënin vatrat e pazëvendësueshme të atdhetarizmit. Viti 1990 u bë viti i pajtimit të gjaqeve. Një moment kulmor është tubimi a kuvendi te Verrat e Llukës, ndonëse i mbajtur në kushtet e shoqërimit dhe rrethimit të hekurt ushtarako-policor serb. Kështu, më 26-30 shtator 1991 u organizua Referendumi për t’i

¹ Kosova në vështrim enciklopedik, Botimet Toena, 1999, f. 27.

dhënë Kosovës legjitimitetin e nevojshëm si shtet sovran dhe i pavarur. Krahas kërkesave të shqiptarëve për t'i realizuar të drejtat e tyre të ligjshme, pushteti serb rriste represionin, duke keqtrajtuar e burgosur, duke dëbuar nxënësit, studentët e mësimdhënësit nga shkollat e fakultetet, duke përjashtuar të gjithë punëtorët shqiptarë nga puna me qëllim që, të ndodhur përballë varfërisë ekstreme, t'i detyrojnë të nënshtrohen. Pushteti serb me anën e policisë dhe masave të dhunshme nga administrata, arsimit, shëndetësia e deri te ekonomia, drejtonte aparatin shtetëror, por jo edhe organizimin e brendshëm të shqiptarëve, i cili kishte filluar të tregonte shenjat e qarta “të jetës paralele”, që pas pak do të kthehet në pushtet e shtet paralel. Kah fundi i vitit 1991 u zgjodh Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në këtë kohë shumë shqiptarë, të cilët shfaqnin pakënaqësinë e tyre duke demonstruar kundër orës policore”, kundër represionit serb dhe pranisë së ushtrisë e policisë në çdo hap, u arrestuan, u burgosën, u plagosën dhe u vranë. Vriteshin pa mëshirë edhe ushtarët në APJ, të cilët ktheheshin në arkivole. Në këtë kohë forcat politike shqiptare, LDK-ja (u themelua më 23 dhjetor 1989) dhe disa parti të tjera që u formuan në këtë kohë, me qëllim të ruajtjes së substancës njerëzore, ndiqnin një politikë paqësore e me veprimtari diplomatike. Meqë shpalljen e Republikës së Kosovës nuk e kishte përkrahur e njohur asnjë shtet, kjo i dha dorë Serbisë që të zbatojë pastrimin etnik të shqiptarëve. Për të parandaluar dhunën e terrorin serb, doli në skenë UÇK. Ajo doli nga ilegaliteti më 28 nëntor 1998.

Serbia mobilizoi forca të mëdha dhe urdhëroi një “mësymje të përgjithshme” për ta zhdukur përfundimisht jo vetëm UÇK-në, por edhe gjithë përkrahësit e saj, domethënë ata që e dëshironin lirinë – popullin e Kosovës. Meqë këtë nuk arrinte ta bënte dot, pavarësisht se kishte epërsi shumë më të mëdha në armatim e numër ushtarësh, policësh, paramilitarësh, mercenarësh etj., gjithë egërsinë e shfrynte mbi popullatën civile të fshatrave e qyteteve. Kështu, Grupi i Kontaktit (fuqitë euro-amerikane) zgjodhi Kështjellën e Rambujesë për të biseduar lidhur me çështjen e Kosovës. Meqë dokumentin bazë me emrin “*Marrëveshje e ndërmjetme për paqen dhe vetëqeverisje në Kosovë*” nuk e nënshkroi delegacioni serb, gjithë përgjegjësia i ra S. Millosheviqit, i cili nuk e kishte ndërmend të ndalonte dhunën, terrorin e gjenocidin mbi shqiptarët. Konferenca e Rambujesë ishte pakti i parë i shqiptarëve me NATO-n. NATO ishte përgatitur për të ndaluar gjenocidin serb dhe ishte lufta e parë e saj për Kosovën. Zgjidhja e çështjes së Kosovës ishte interes evropian, i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe gjithë botës demokratike. Më 24 mars 1999, një ditë pas nënshkrimit të njëanshëm të marrëveshjes, edhe përkundër kundërshtimit të Ruisisë, forcat e NATO-s goditën caqet ushtarake e policore serbe. Serbia kishte dërguar mbi 40 000 trupa ushtarake, policore e

paramilitare në Kosovë, që bënë masakra e barbari mbi popullatë civile shqiptare. Ky terror shtetëror është aplikuar në të gjitha viset ku jetojnë shqiptarët: në Drenicë (Prekaz, Izbicë, Radishevë, Skënderaj, Kotorr, Baks, Shtuticë, Çikatovë, Vërbovc, Gllanasellë, Gradicë, Poklek, Rezallë, Abri, Padalishtë etj.), në Dukagjin, Gjakovë, Korenicë, Kralan, në Podgur, në Burgun e Dubravës, në Anamoravë, në Pejë, në Reçak, në Llap e Gallup, në Prapashticë, Keqekollë, në Lipjan, në Kabash, në Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Klinë, në komunën e Prizrenit, Malishevës, në Has, në Gjilan, në Lubizhdë (Viti), në komunën e Prishtinës, Fushë Kosovë, në Hallaq, në Beleg, në Celinë, në Goden, në Kotlinë (1999), në Krushë të Madhe, në Pastasel, në Qyshk, në Rogovë, në Studime të Vushtrrisë, Mitrovicë me rrethinë, sidomos në Shalë të Bajgorës etj. Pra, në gjithë Kosovën janë bërë krime e masakra të tmerrshme. Këtu më poshtë do t'i shënojmë në mënyrë kronologjike masakrat e krimet e ushtrisë, policisë e grupeve paramilitare serbe që i kanë bërë në Kosovë gjatë periudhës dhjetëvjeçare.

Krimi serb i ngritur në sistem gjatë periudhës 1998-1999

Masakra në Likoshan dhe Qirez është bërë më 28 shkurt dhe 1 mars 1998, ku forcat policore serbe kanë vrarë 24 banorë të familjes Ahmeti nga fshati Likoshan, Sejdiu nga fshati Qirez etj., që u përkisnin moshave të ndryshme. Kriminelët serbë kanë vrarë edhe një nënë shtatzënë.² Gjatë vitit 1999 janë vrarë edhe 9 banorë, ndërsa 3 banorë civilë ende konsiderohen të zhdukur.³ Masakër gjithashtu e rëndë, që bëri jehonë në vend e në botë, ka qenë ajo në Prekaz më 5-7 mars 1998, ku janë vrarë 59 banorë, 55 kanë qenë të lagjes Jashari (20 anëtarë i përkisnin vetëm familjes së komandantit të UÇK-së, Adem Jashari).⁴ Më 31 maj 1998, forca të mëdha policore të stacionuara në Drenas, sulmuan banorët në Poklek të Ri dhe në shtëpitë e oborret e tyre vranë pa asnjë shkas dhjetë shqiptarë. Më 18 korrik forcat policore serbe kanë sulmuar fshatin Bellacërkë të Rahovecit, ku kanë vrarë 12 banorë shqiptarë. Më 25 korrik 1998, forcat serbe kanë djegur fshatrat

² *Fjalori enciklopedik i Kosovës II*, ASHAK, Prishtinë, 2018, f. 1056; Jusuf Osmani, Masakrat dhe vrasjet masive në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 281.

³ Bujar Tahiri, *Krimet serbe në fshatin Likoshan të Drenasit gjatë viteve 1998-1999*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 660-661.

⁴ Besim Morina, *Familja Jashari - shembull unik në botë i sakrificës njerëzore për liri*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 314-326.

Radishevë e Kotorr dhe kanë vrarë këta banorë: Azem Beqir Hajrizin, Beqir Mujë Hajrizin, Faik Beqir Hajrizin, Sabit Sadri Ahmetajn, Alban Muhamet Ahmetajn, Haxhi Imer Ahmetajn, Shyqeri Azem Ahmetajn, Miradije Bislim Tahirajn, Feriz Ramiz Selimin dhe Ramadan Halim Tahirajn, ndërsa dy javë më vonë, pikërisht më 8 gusht 1998 kanë rënë dëshmorë në altarin e lirisë dy ushtarë të UÇK-së: Kapllan Ali Ahmetaj dhe Musa Shyqeri Ahmetaj. Në këtë kohë është vrarë në Runik Jahir Bahtir Fazliu nga Kotorri. Më 20 janar 1999 është vrarë në Vaganicë të Mitrovicës Afrim Sinan Hajrizi, ushtar i UÇK-së, Eset Behram Hajrizi (më 24 mars në Mitrovicë), kurse në prill të vitit 1999, në fshatin Dreth, është likuiduar në rrethana misterioze Demir Sadri Ahmetaj, profesor.⁵

Më 26 gusht 1998, nga granatimet që bënë forcat ushtarake e policore serbe mbi fshatrat Greiçevc dhe Topillë të komunës së Suharekës, janë vrarë 11 anëtarë të familjes Asllani (8 fëmijë e 3 gra) dhe plagosën disa të tjerë të fshatit Rancë. Më 27 gusht 1998 forcat serbe kanë djegur fshatin Kleçkë dhe kanë vrarë 8 banorë e mbi 30 të tjerë kanë plagosur. Gati të gjithë të vrarët kanë qenë fëmijë dhe të moshuar. Dy ditë më vonë, më 29 gusht 1998, policia serbe vranë tetë anëtarë të familjes Salihaj në fshatin Shushicë të Istogut.

Më 15-17 shtator 1998 në një sulm të përbashkët të policisë, ushtrisë dhe paramilitarëve serbë në fshatrat e Shalës së Bajgorës vranë 14 banorë shqiptarë, kryesisht gra, fëmijë dhe pleq dhe dogjën e plaçkitën fshatrat: Cerajë, Bisticë, Dedi, Zabërgjë, Vidishiq, Vllahi, Koshtovë, Boletin, Bare, Bajgorë, Kaçanoll, Tërstenë, Rashan Mazhiq etj. Në ofensivën e 22-24 shtatorit 1998 policia, ushtria në bashkëpunim edhe me paraushtarakë e civilë serbë, me armë më moderne sulmuan fshatrat e Qyqavicës, duke vrarë 24 shqiptarë të moshave të ndryshme, në mesin e tyre Enver Halitin, profesor dhe i burgosur politik, eprorin e UÇK-së, prof. Murat Halitin etj. Më 26 shtator 1998 forcat kriminale serbe sulmuan fshatin Gullboc të Malishevës, ku keqtrajtuan fizikisht shumë fshatarë dhe vranë 14 sish. Po atë ditë shtatë familje të trungut familjar Deliu në Abri të Epërme pësoi tragjedi të rëndë. U vranë e masakruan 22 anëtarë: gra, fëmijë, pleq, banorë të pafuqishëm, madje nuk u kursye as foshnja gjashtëmuajshe: 10 anëtarë të familjes së Sali Imer Deliu; 4 anëtarë të familjes së Idriz Hysen Deliu; 5 anëtarë të familjes së Fazli Ramë Deliu, 1 anëtar i familjes së Zeqir Jonuz Deliu; 1 anëtar i familjes së Ali Deli Deliu; 1 anëtar i familjes së Pajazit

⁵ Fazli Hajrizi, *Krimet serbe në fshatrat Radishevë e Kotorr*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” I, Prizren, 2023, f. 251-275.

Rrustem Deliu dhe 1 anëtar i familjes së Sherif Rrustem Deliu.⁶ Më 22 tetor 1998, derisa anëtarët e familjes Sylmetaj nga Greçina e Hasit po ktheheshin në shtëpinë e tyre, forcat ushtarake vranë dhe plagosën disa prej tyre. Më 14 dhjetor 1998, duke kaluar kufirin Shqipëri-Kosovë, në ballafaqim me forcat ushtarake serbe, në fushëbetejë kanë rënë heroikisht 41 luftëtarë të UÇK-së bashkë me komandantin e tyre, Mujë Krasniqi.⁷

Nga janari e deri në përfundim të luftës forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe kanë bërë krime monstruoze mbi popullatën shqiptare në shumë mjedise të Kosovës. Masakra më e rëndë e ushtrisë e policisë kriminale serbe ka qenë ajo e Reçakut, më 15-17 janar 1999, ku vranë e masakruan 43 banorë të moshave të ndryshme. Mbi njëzet ka qenë edhe numri i të plagosurve. Këtë krim të rëndë e bëri të njohur për opinionin ndërkombëtar shefi i misionit të OSBE-së, ambasadori Uilliam Uoker.⁸ Udhëheqësit serbë të krimeve, për të humbur gjurmë, dërguan ekipet e tyre në Reçak gjoja për të bërë obduksionin e kufomave (17 janar), mirëpo këtë gjë nuk e lejuan përfaqësuesit e OSBE-së. Pamjet e tmerrit ishin shpërndarë në gjithë globin dhe kishin tmerruar botën demokratike. Varrimi i kufomave është bërë më 11 shkurt 1999, ku shefi i Misionit Verifikues në tubimin mortor njoftoi opinionin ndërkombëtar se “...në Reçak është kryer krim kundër njerëzimit”.⁹

Pas masakrës së Reçakut, më 27-29 janar 1999, forcat kriminale serbe sulmuan fshatin Rogovë të Gjakovës, ku vranë e masakruan 26 shqiptarë (18 pjesëtarë të UÇK-së dhe 8 civilë). Banorët e tjerë janë torturuar fizikisht dhe janë dëbuar me dhunë nga shtëpitë e tyre, duke i detyruar që të shkojnë në Shqipëri.¹⁰ Tri ditë më vonë, më 2 mars 1999, në Leshan të Suharekës kriminelët serbë vranë 29 banorë. Më 6 mars 1999, piromanët serbë, pasi dogjën dhjetëra shtëpi në fshatin Reznik të Vushtrrisë, vranë 9 anëtarë të familjes Ujkani, kufomat e të cilëve pastaj i dogjën. Më 3 mars 1999, forcat ushtarake-policore granatuan qendrën e qytetit të Mitrovicës (Tregun e Gjellbër), ku u vranë gjashtë shqiptarë dhe 128 të tjerë

⁶ *Fjalori enciklopedik i Kosovës, ASHAK*, Prishtinë, 2018, f. 1052-1053; Afrim Hysenaj, *Masakrat serbe në Abri të Epërme (1997-1999)*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 555-560.

⁷ Sabit Muçaj, *Krimet serbe në rajonin e Hasit*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 435-451.

⁸ *Fjalori enciklopedik i Kosovës...*, f. 1058-1059.

⁹ Ruzhdi Jashari, *Masakra e Reçakut - fundi i okupimit serb në Kosovë*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” I, Prizren, 2023, f. 439-547.

¹⁰ *Fjalori enciklopedik i Kosovës...*, f. 1059; Sabit Muçaj, *Krimet serbe në rajonin e Hasit*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 435-451.

u plagosën. Disa prej tyre kanë mbetur invalidë të përjetshëm.¹¹ Në një sulm që organizuan më 20 mars 1999, në disa lagje të Skënderajt, forcat serbe pa asnjë arsye vranë 29 banorë shqiptarë të moshës 15-70 vjeçare. Në një sulm tjetër më 16 prill, kriminelët serbë vranë 16 banorë civilë të qytetit dhe fshatrave përreth.¹² Po këtë ditë kanë granatuar fshatin Tërnavë të Podujevës, ku kanë vrarë disa shqiptarë, në mesin e tyre edhe dy fëmijë. Më 12 mars dhe 4-6 qershor 1999 kriminelët serbë kanë vrarë 15 banorë të fshatit Katund i Ri (Pejë), ndërsa më 20 mars 1999, në Keçekollë të Prishtinës kanë vrarë pesë anëtarë të familjes Jakupi të fshatit Orllan të Podujevës.¹³

Pas tërheqjes së vëzhguesve të OSBE-së dhe fillimit të bombardimeve të NATO-s mbi caqet ushtarake e policore serbe, më 24 mars 1999 forca të mëdha serbe, mbi 7 000 ushtarë e policë, me armatim të rëndë (tanke e autoblanda) sulmuan fshatin Kotlinë të Kaçanikut, ku vranë e masakruan 26 banorë, shumë të tjerë i keqtrajtuuan fizikisht (gra, fëmijë e pleq). Kriminelët serbë i hodhën 12 të rinj në puse dhe, pasi vunë eksplozivin, për të humbur gjurmë, i rrafshuan me ekskavator.¹⁴ Po atë ditë (më 24 mars 1999) kriminelët serbë kanë vrarë shumë banorë (mbi 30 sish) në Podujevë.

Më 25-28 mars 1999 në fshatrat Celinë e Bellacërkë të Rahovecit forcat ushtarake dhe policore të Serbisë kanë vrarë dhe masakruar në shtëpitë e tyre qindra civilë shqiptarë (82 në Celinë e 46 në Bellacërkë). Në mesin e të vrarëve ka pasur shumë fëmijë (11), gra (7), pleq e të moshës madhore (58). Për t'ua pamundësuar kthimin banorëve të tjerë, të cilët u dëbuan me dhunë në Shqipëri, serbët kanë djegur të gjitha shtëpitë. Pas luftës, kur është bërë zhvarrimi i kufomave (14 korrik 1999), ka marrë pjesë kryeprokurorja e Tribunalit të Hagës, Luiz Arbur.¹⁵ Po më 25 mars 1999, një ditë pasi Aleanca Veriatlantike (NATO), filloi bombardimet mbi caqet ushtarake e policore serbe, kriminelët serbë kanë vrarë 28 shqiptarë në fshatin Goden të Hasit, komuna e Gjakovës. Piromanët serbë pastaj dogjën shtëpitë dhe objektin e shkollës.¹⁶ Po këtë ditë kriminelët serbë vranë tetë

¹¹ *Fjalori enciklopedik i Kosovës...*, f. 1063-1064.

¹² Po aty, f. 1060.

¹³ Po aty, f. 1062.

¹⁴ Po aty, f. 1055-1056.

¹⁵ Po aty, f. 1054; Jeton Mrasori, *Krimet serbe në komunën e Rahovecit*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 452-462.

¹⁶ Bedri Muhadri, *Masakra dhe gjenocidi serb në Has (1998-1999)*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 371-380.

anëtarë të familjes Pajaziti në Randobravë (Prizren).¹⁷

Në mesin e të vrarëve ishte nëna shtatzënë me katër fëmijët e saj (2-7 vjeç). Një ditë më vonë, më 26 mars 1999, forcat ushtarake, policore, paramilitare bashkë me serbët lokalë sulmuan fshatrat Krushë e Vogël, ku vranë e masakruan 113 banorë, dhe Krushë e Madhe të Rahovecit, ku vranë e masakruan 241 shqiptarë, kryesisht gra, fëmijë e pleq. Në mesin e të vrarëve ka pasur dhjetëra intelektualë (mësimdhënës, inxhinierë, mjekë etj.).¹⁸ Më 26 qershor 2006 është gjetur një varrezë masive me 26 kufoma të varrosura në mes të fshatrave Lugishtë e Korishë. U konstatua se të vrarët janë nga Krusha e Vogël, të cilët janë ekzekutuar nga forcat ushtarake e policore serbe më 26 mars 1999.¹⁹

Dita e 25 e 26 marsit 1999 ka qenë tragjike edhe për banorët e Suharekës, ku kriminelët serbë masakruan 57 anëtarë të familja Berisha. Forcat ushtarake e policore serbe vranë edhe banorë të tjerë në afërsi të stacionit të autobusëve. Për të humbur gjurmë, kufomat e të vrarëve i ngarkojnë në kamion të mbuluar dhe i dërgojnë në poligonin e kazermës në Prizren e prej aty në Batajnicë afër Beogradit.²⁰ Më 25 mars 1999 në fshatin Tërnjë (Suharekë) kriminelët serbë, pjesëtarë të Brigadës së Motorizuar 549 të ushtrisë së Jugosllavisë, kanë vrarë 28 banorë civilë, kryesisht gra, pleq e fëmijë.²¹ Në fshatin Padalishtë të Istogut forcat ushtarake e policore serbe kanë vrarë 19 anëtarë të familjes Imeri të moshës prej 2 -76 vjeç, ndërsa në fshatin Landovicë të Prizrenit kanë vrarë 23 shqiptarë.²² Më 27 mars 1999 forcat serbe, kanë sulmuar fshatin Mamushë të Prizrenit ku kanë vrarë e masakruar 18 banorë, ndërsa të tjerët i kanë dëbuar me dhunë në Shqipëri. Po atë ditë në fshatin Kryshec të Obiliqit forcat serbe kanë vrarë 11 anëtarë të familjes Rama, ndërsa në Gjakovë kanë vrarë gjashtë anëtarë të familjes Çerkezi. Ndër masakrat më të rënda që kanë bërë forcat ushtarake e policore serbe, ka qenë ajo e 20 marsit 1999 në Izbicë të komunës së Skënderajt (katër ditë para fillimit të bombardimeve të NATO-s. ku kriminelët serbë kanë ekzekutuar 143 civilë shqiptarë. Shumica e banorëve të vrarë kanë

¹⁷ Sabit Muçaj, *Krimet serbe në rajonin e Hasit*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 435-451.

¹⁸ *Fjalori enciklopedik i Kosovës...*, f. 1055-1056; B. Muhadri, *Masakra dhe gjenocidi serb në Has...*, f. 371-380; S. Muçaj, *Krimet serbe në rajonin e Hasit...*, f. 435-451; J. Mrasori, *Krimet serbe në komunën e Rahovecit...*, f. 452-462.

¹⁹ Sheradin Berisha, *Masakra e Tusuzit në Prizren më 26 maj 1999 – gjenocid i pandëshkuar*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 563-575.

²⁰ *Fjalori enciklopedik i Kosovës...*, f. 1060-1061.

²¹ Po aty, f. 1062.

²² Po aty, f. 1057.

qenë të fshatrave përreth (gra, pleq, fëmijë, burra, invalidë), që, për t'i ikur dhunës e terrorit serb, janë strehuar në Izbicë. Kjo masakër që ishte njëra ndër më të mëdhatë në Kosovë, tronditi gjithë popullin shqiptar, vendet perëndimore, SHBA-në dhe botën e civilizuar.²³ Më 11 maj 1999, në lagjen e Xhemajlajve të Izbicës kriminelët serbë vranë e masakruan 12 banorë të fshatit Burojë. Po atë ditë, në Matiçan të Prishtinës, forcat serbe kanë vrarë 21 banorë civilë shqiptarë; në Podujevë kanë vrarë 19 shqiptarë etj.²⁴

Në 28 mars 1999, pjesëtarë të njësisë paramilitare serbe “Shkorpion” (të njësisë rezervë ushtarake) kanë ekzekutuar 19 anëtarë të familjes Bogujevci të Podujevës, kryesisht gra, fëmijë dhe pleq. Ka shpëtuar vajza 13-vjeçare, Saranda Bogujevci.²⁵ Më 29 e 30 mars 1999 forcat ushtarake dhe policore të Serbisë sulmuan fshatin Beleg të Deçanit, ku ishin strehuar shumë banorë të zhvendosur të fshatrave Drenoc, Sllup, Irzniq, Hulaj, Carrabreg etj. Kriminelët serbë, pasi i torturuan, i plaçkitën dhe ua morën dokumentacionin, ekzekutuan 44 banorë shqiptarë të fshatit Beleg, 7 banorë të fshatit Irzniq, 9 banorë të fshatit Kodrali etj. Për të humbur gjurmë, kufoma i kanë djegur në një shtëpi të lagjes Vishaj të Belegut.²⁶ Më 29 mars 1999 forcat kriminale serbe ushtruan dhunë e terror mbi popullatën e komunës së Vushtrisë e Mitrovicës. Në Dumnicë të Epërme (Vushtrri) vranë gjashtë banorë, në mesin e tyre tre fëmijë, ndërsa në lagjen “Bair” të Mitrovicës pushkatuan disa invalidë shqiptarë, të cilët nuk kishin pasur mundësi të lëviznin e të largoheshin nga shtëpitë e tyre.²⁷ Po këtë ditë forcat serbe kanë ekzekutuar 11 banorë shqiptarë të fshatit Potërc i Epërm (Klinë). Më 30 mars 1999 në Llashticë të Gjilanit forcat serbe kanë vrarë 22 banorë shqiptarë, madje edhe fëmijë. Më 30-31 mars 1999 në Burim e Turjakë të Malishevës kanë vrarë e masakruar shumë banorë të moshës prej 16-72 vjeçare. Në fshatin Burim (ish-Javiq) forcat ushtarake e policore serbe kanë vrarë dhe djegur 41 banorë civilë shqiptarë, në mesin e tyre edhe katër femra të dhunuara. Disa shqiptarë janë masakruar me sëpatë e mjete të tjera të mprehta.²⁸

²³ Besim Morina & Agim Hyseni, *Vrasjet masive të mbi 260 civilëve shqiptarë në Izbicë dhe Çikatovë të Vjetër të Drenasit*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 495-503.

²⁴ *Fjalori enciklopedik i Kosovës...*, f. 1055.

²⁵ Po aty, f. 1062.

²⁶ Po aty, f. 1053. Ismet Haskaj, *Masakrat në komunën e Deçanit (1998-1999)*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 548-554.

²⁷ *Fjalori enciklopedik i Kosovës...*, f. 1063-1064.

²⁸ Habib N. Zogaj, *Faktimi i krimit në vendin e ngjarjes (Masakra e Burimit dhe e Turjakës)*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 537-538.

Në masakrën e Pastaselit, komuna e Rahovecit, më 31 mars 1999, forcat serbe kanë vrarë e masakruar 106 banorë civilë shqiptarë të fshatrave Pastasel, Kramovik, Polluzhë, Çifllak, Kaznik, Gremnik i Klinës, Peja, Skënderaj etj. Disa kufoma janë djegur. Atyre paraprakisht u janë konfiskuar i gjithë dokumentacioni, paratë, stolitë etj. Banorët që i kanë shpëtuar masakrës i kanë varrosur më të dashurit e tyre, mirëpo më 21 prill 1999, kriminelët serbë, për të humbur gjurmët e krimit, i kanë zhvarrosur kufomat dhe i kanë dërguar me kamionë në drejtim të panjohur.²⁹

Më 1 prill 1999 në fshatin Lybeniq të Pejës kriminelët serbë kanë vrarë 66 civilë shqiptarë, ndërsa kanë plagosur dhjetëra të tjerë. Më 7 prill kriminelët serbë vranë edhe banorë të tjerë të këtyre fshatrave: 9 nga Lybeniqi, 18 nga Raushiqi, 10 nga Buçani dhe disa të tjerë nga fshatrat e Pejës dhe Deçanit. Shumë nga kufomat janë masakruar, madje u janë prerë edhe kokat e gjymtyrët.³⁰ Në fshatin Cërcë të Istogut kriminelët serbë vranë dhe dogjën gjashtë anëtarë të familjes Rexha. Në tragjedi të tillë të nesërmen pësoi edhe familja Vejsa në Gjakovë, ku u ekzekutua nëna me pesë fëmijët e saj nën moshën dhjetëvjeçare. Më 2 prill 1999, forcat serbe sulmua fshatin Nagac, ku vranë 31 banorë të fshatrave Nagac, Brestovc, Krushë e Madhe etj., ndërsa në fshatin Sopi të Suharekës kanë vrarë e masakruar 35 shqiptarë.³¹ Më 2-4 prill 1999 forcat ushtarake e policore serbe kryen masakër të rëndë në fshatin Kralan të Gjakovës, ku vranë e masakruan 87 banorë, kryesisht të rinj të kominës së Klinës (70), Malishevës (14), Gjakovës (2) dhe Vajnikut të Skënderajt (1).³² Më 5 prill 1999, forcat ushtarake e policore serbe sulmuan fshatin Rezallë të komunës së Skënderajt, ku vranë e masakruan 41 banorë civilë shqiptarë (29 nga Rezalla, 7 nga Marina dhe 2 nga fshati Llaticë e Prekaz. Pasi i hedhin bashkë me trupat e ngordhur të kafshëve në një gropë të hapur me ekskavator, më 16 maj i zhvarrosin dhe i dërgojnë në drejtim të panjohur. Gjatë luftës së fundit në Kosovë në Rezallë janë vrarë 80 banorë.³³ Më 12 prill 1999, forcat serbe në Luginë të (Has, komuna e Prizrenit) vranë dhe masakruan 18 banorë shqiptarë (15 nga Luginës dhe 3 nga fshati Damjan, lagja Shehu, të cilët i varrosën në një varrezë masive. Pas përfundimit të luftës janë zbuluar edhe të varrosurit e tjerë në vendet përreth.³⁴ Gjatë luftës

²⁹ *Fjalori enciklopedik i Kosovës II*, ASHAK, Prishtinë, 2018, f. 1055-1056; J. Mrasori, *Krimet serbe në komunën e Rahovecit...*, f. 452-462.

³⁰ *Fjalori enciklopedik i Kosovës*, ASHAK, Prishtinë, 2018, f. 1063.

³¹ J. Mrasori, *Krimet serbe në komunën e Rahovecit...*, f. 452-462.

³² Kristinë Oroshi, *Masakra e Kralanit*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 217-239.

³³ *Fjalori enciklopedik i Kosovës...*, f. 1059.

³⁴ B. Muhadri, *Masakra dhe gjenocidi serb në Has...*, f. 371-380.

(1998-1999) forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe kanë vrarë qindra banorë në fshatrat e Hasit, madje edhe të moshës jomadhore: Gorozhup, Milaj, Mazrek, Gjonaj, Tupec-Karashëngjergj, Bregdri, Krajk, Lukinj, Romajë, Dedaj, Lugishtë, Kabash, Kushnin etj. Dhjetëra civilë shqiptarë janë plagosur, ndërsa disa konsiderohen të zhdukur. Për t'ua pamundësuar kthimin në vatrën e tyre stërgjyshore, piromanët serbë kanë plaçkitur e djegur gati çdo shtëpi.³⁵ Më 14 prill 1999, forcat ushtarake, policore bashkë me paramilitare serbë ndërmorën një aksion të përgjithshëm për dëbimin e popullatës shqiptare nga banesat dhe shtëpitë e tyre në lagjen e Kovaçëve. Gjatë këtij aksioni ata kanë vrarë 39 shqiptarë të moshave të ndryshme. Në këtë kohë (prill 1999), në përpjekje për t'u larguar në drejtim të Rozhajës, në fshatin Dreth në veri të Runikut, janë zënë dhe ekzekutuar 23 shqiptarë, kryesisht nga Mitrovica me arsimim të lartë, në fshatin Dreth. Kufomat e tyre janë varrosur në një varrezë masive, por deri më sot nuk është zbuluar, prandaj të vrarët konsiderohen të pagjetur a të zhdukur.³⁶

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, në korrik të vitit 1999 janë zbuluar tri varreza masive në fshatrat e Hasit: në Gorozhup dhe Plaejë - 2 varreza masive me nga 12 kufoma, ë Mazrek - një varr me 10 kufoma. U konstatua se të gjithë të vrarët ishin nga fshati Lugishtë (Luizhdë) e Hasit të Prizrenit të ekzekutuar gjatë periudhës 12-26 prill 1999.³⁷ Më 15-16 prill 1999, forcat ushtarake e policore serbe kanë sulmuar fshatin Sillovi të Lipjanit, ku kanë vrarë 45 banorë civilë shqiptarë dhe kanë plagosur dhjetëra të tjerë. Kriminelët serbë kanë ekzekutuar me thika e bajoneta edhe fëmijë, madje para syve të prindërve të tyre. Autopsinë e kufomave e kanë bërë hetuesit e Tribunalit të Hagës.³⁸ Më 16 e 17 prill 1999, forcat serbe kanë vrarë dhjetëra banorë civilë të familjes Morina dhe Makolli në fshatin Gllanasellë të Gillogovcit. Pas gjetjeve mortore në Serbi, dëshmohet se kufomat e të vrarëve në Shavarina nuk janë të përziera me trupat e ekzekutuar në Çikatovë të Vjetër.³⁹ Në fshatin Gllanaselë forcat ushtarake e policore serbe kanë vrarë 5 anëtarë të familjes Berisha, 11 anëtarë të

³⁵ Zog Çoçaj, *Masakrat në fshatrat e Hasit të Prizrenit*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 463-469.

³⁶ *Fjalori enciklopedik i Kosovës...*, f. 1063-1064.

³⁷ Sh. Berisha, *Masakra e Tuzusit në Prizren...*, f. 563-571.

³⁸ *Fjalori enciklopedik i Kosovës...*, f. 1060; Sefer Tasholli, *Terrori serb në komunën e Lipjanit*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 423-434.

³⁹ B. Morina, *Krimet e kryera serbe në fshatin Çikatovë e Vjetër të Drenasit...*, f. 631-643; Besim Morina & Agim Hyseni, *Vrasjet masive të mbi 260 civilëve shqiptarë në Izbicë dhe Çikatovë të Vjetër të Drenasit*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 495-503.

familjes Nika, 6 anëtarë të familjes Topilla, 19 anëtarë të familjes Krasniqi, 6 anëtarë të familjes Lluguni, 3 anëtarë të familjes Karaçica, 2 të familjes Kurrumeli, 1 i familjes Lladrovci, 3 të familjes Maloku (të ekzekutuar në Çikatovë), 2 të familjes Bunjaku dhe 1 i familjes Mehani.⁴⁰ Më 31 janar 1990, në demonstratat kundër dhunës e terrorit serb janë vrarë Enver Morina nga Çikatova e Drenasit, Shani Morina nga Çikatova e Vjetër dhe Sahit Shala nga Krejkova. Më 17 prill 1999 forcat ushtarake e policore serbe sulmuan Poklekun e Vjetër (Gllogovc), ku vranë 54 shqiptarë, kufomat e të cilëve i dogjën. Banorët parapakisht i kanë futur brenda në një shtëpi, ku janë qëlluar me armë e pastaj, për të humbur gjurmë, u është vënë flaka. Në këtë ployë është vrarë dhe djegur shkrintari Ymer Elshani.

Që nga 26 maji 1998 e deri në më 14 qershor 1999 forcat ushtarake, policore e paramilitare serbe kanë bërë krime edhe në fshatrat e tjera të komunës së Drenasit (Gllogovcit): Dobrashec, Poklek, Likoshan, Çikatovë, Vasilevë etj. Gjatë periudhës 1998-1999 janë vrarë 19 banorë civilë shqiptarë dhe një luftëtar i lirisë. Në mesin e të vrarëve janë 5 fëmijë nën moshën 18-vjeçare, madje edhe një foshnje katërmuajshe. Janë plagosur 4 banorë. Piromanët serbë kanë djegur gati të gjitha shtëpitë e fshatit Dobrashefc.⁴¹

Më 26 maj 1999, forca të shumta ushtarake, policore e militare serbe ndërmoren ofensivë të furishme shkatërrimtare në Prizren, ku plaçkitën, dogjën e shkatërruan 245 shtëpi të lagjes Tuzus. Pasi ndanë gratë dhe fëmijët, duke i urdhëruar që të nisen menjëherë për në Shqipëri, ekzekutuan 25 meshkuj të moshave të ndryshme.⁴² Në Prizren, në lagjet e qytetit dhe në fshatrat e kësaj komune (Tuzus, Korishë, Krushë e Madhe, Krushë e Vogël, Randobravë, Kabash, Lubizhdë, Landovicë, Reshkovë, Luginishtë, Lybiqevë, Zojz, Hoçë, Mazrek, Struzhë, Milaj, Napregosht, Karashëngjergj etj., forcat serbe kanë vrarë 328 banorë shqiptarë të moshave të ndryshme, madje edhe fëmijë, gra e pleq, ndërsa kanë plagosur 90 banorë civilë të tjerë.⁴³ Më 18 prill 1999, forcat ushtarake e policore serbe vranë 25 banorë (19 të fshatit Ribar i Vogël e 6 të familjes Vuniqi të fshatit Vërshec të komunës së

⁴⁰ Ilir S. Nika, *Krimet serbe gjatë viteve 1998-1999 në fshatin Gllanasellë të Drenasit*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 656-659.

⁴¹ Izet Avdyli, *Krimet serbe në Dobrashec të Drenasit (1998-1999)*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 561-562.

⁴² Sh. Berisha, *Masakra e Tusuzit në Prizren...*, f. 563-575.

⁴³ Nue Oroshi, *Prizreni qytet i Besëlidhjes Shqiptare, qytet i qëndresës dhe masakrimeve e vuajtjeve sublime*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 616-630.

Lipjanit, moshë e të cilëve ka qenë prej 7-90 vjeç. Përveç krimeve në njerëz, forcat serbe kanë plaçkitur çdo gjë dhe djegur të gjitha shtëpitë shqiptare.⁴⁴ Më 19 prill 1999 forcat policore dhe ushtarake të Serbisë bënë masakër ndaj banorëve shqiptarë të fshatit Hallaq i Vogël të komunës së Lipjanit. Nga 40 meshkujt e grumbulluar, 13 i pushkatuan në prani të prindërve dhe fëmijëve të tyre.⁴⁵ Dita e 21 prillit 1999 ka qenë e kobshme për banorët e Fushë-Kosovës, sidomos për familjen Mirena të fshatit Nakadër me prejardhje nga fshati Hade, ku forcat serbe vranë dhe masakruan 16 meshkuj nga moshë 18 deri në 58 vjeç.⁴⁶

Qëllimi i parë dhe i fundit i regjimit të Beogradit ka qenë spastrimi etnik i Kosovës, sidomos i brezit kufitar me Shqipërinë. Një ndër operacionet më të rënda dhe vrasjet më të mëdha masive që bëri ushtria dhe policia serbe është ajo 27 prillit 1999, ku ekzekutuan e masakruan 376 shqiptarë civilë të moshave të ndryshme, plaçkitën, dogjën e shkatërruan gjithçka, dëbuan një masë të madhe të popullatës nga vatrat e tyre stërgjyshore (Meje, Korenicë, Ramoc, Madanaj, Pacaj, Dobrosh etj.). Në fshatin Meje (komuna e Gjakovës) tubuan 348 civilë të moshës 14-86 vjeç (meshkuj e femra). Aty u ekzekutuan 309 shqiptarë, mbetjet mortore të të cilëve janë zbuluar pas përfundimit të luftës në një varrezë masive afër Beogradit.⁴⁷ Në Batajnicë afër kryeqytetit të Serbisë janë varrosur në varreza masive mbi 8 000 trupa të shqiptarëve, kryesisht civilë të moshave të ndryshme, fëmijë, gra, pleq, që ushtria, policia dhe paramilitarët serbë i kanë vrarë në mjedise të ndryshme të Kosovës. Varreza të tjera masive ka edhe në vende të ndryshme të Serbisë, si: Petrovosellë (2 varreza masive), Rudnicë – Rashkë (mbi 250 shqiptarë të vrarë e masakruar), në liqenin Peroçaci (është gjetur një kamion frigorifer me kufoma të shqiptarëve).⁴⁸ Më 30 prill 1999, forcat ushtarake e policore serbe ndërmorën një ofensivë, duke sulmuar banorët shqiptarë të fshatrave Shtuticë, Vërbofc, Baks etj. Ata i kishin nisur në drejtim të Drenasit dhe gjatë rrugës, në vendin e quajtur “Shavarina” (Çikatovës së Vjetër afër Drenasit), i kanë pushkatuar mbi 120 sish (20 të fshatit Baks: 3 të lagjes Bucolli, 7 të lagjes Muqolli, 5 të lagjes Shaqiri, 5 të lagjes Dushku etj., ndërsa të tjerët i kanë i kanë dërguar në burgun e Lipjanit

⁴⁴ *Fjalori enciklopedik i Kosovës...*, f. 1059.

⁴⁵ Po aty, f. 1055.

⁴⁶ Po aty, f. 1054.

⁴⁷ Po aty, f. 1057.

⁴⁸ Engjëlli Berisha, *Masakra e Korenicës dhe e Mejës, 27 prill 1999-367 shqiptarë të vrarë e të zhdukur brenda një dite*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 470-494.

etj.⁴⁹ Më 2 maj 1999, forcat ushtarake e policore serbe masakruan popullatën shqiptare në Studime të Vushtrrisë, e cila ishte zhvendosur nga shtëpitë e tyre në Vushtri dhe fshatra përreth në përpjekje për t'i shpëtuar dhunës e terrorit. Në Studime janë vrarë 116 civilë shqiptarë të Studimes, Vushtrrisë dhe disa fshatrave të kësaj komune.⁵⁰ Më 13 maj 1999, forcat ushtarake dhe policore sere bënë masakër mbi popullatën shqiptare të fshatit Korishë të Prizrenit, ku ekzekutuan në mënyrë mizore 77 banorë, anëtarë të familjes Ahmetaj, Rexhaj, Dakaj, Sukaj. Një ditë më vonë, më 14 maj 1999 ndodhi tragjedia tjetër, kur aeroplanët e NATO-s goditën kolonën e refugjatëve shqiptarë të fshatit Korishë, ku gjetën vdekjen 87 banorë dhe mbi 60 të tjerë mbetën të plagosur.⁵¹

Gjatë periudhës prill-maj 1999, forcat ushtarake e policore serbe kanë vrarë dhe masakruar 44 banorë në Vushtri. Shumë sish janë vrarë e mbytur në lumë nga kriminelë, derisa po përpiqeshin të kalonin lumin Sitnicë për t'u strehuar në malet e Qyqavicës. Më 22 maj 1999, forcat ushtarake e policore serbe kanë nxjerrë nga shtëpitë e tyre banorët shqiptarë të qytetit të Vushtrrisë dhe i kanë tubuar në vendin e quajtur (“Te vorret e shehrit”), ku kanë vrarë 68 banorë, ndërsa të tjerët, disa i kanë dërguar në burgun e Smrekonicës e shumë të tjerë i kanë dëbuar në Shqipëri. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, me kërkesën e prindërve dhe trysnisë së ndërkombëtarëve për të zbatuar konventën ndërkombëtare, Serbia u detyrua të gjejë dhe t’ua dorëzojë familjarëve më të dashurit e tyre, të cilët i kanë rrvarroshur. Kështu, më 23 dhjetor 2003 janë gjetur 4 kufoma të banorëve shqiptarë, më 23 prill 2004 - 11 kufoma, më 12 qershor 2005 - 6 kufoma, më 15 janar - 15, më 26 korrik - 1 kufomë, më 15 shtator - 1 kufomë dhe më 4 tetor 2005 - 11 kufoma.⁵² Më 22 e 23 maj 1999. Forcat policore dhe paramilitare serbe kanë kryer masakër të rëndë mbi të burgosurit shqiptarë në Burgun e Dubravës, ku janë ekzekutuar 170 shqiptarë dhe mbi 300 të tjerë janë plagosur. Masakra mbi të burgosurit shqiptarë të sjellë nga Mitrovica e Sremit, Nishi, kampe të ndryshme dhe burgje tjera të Serbisë në

⁴⁹ B. Morina & A. Hyseni, *Vrasjet masive të mbi 260 civilëve shqiptarë në Izbicë dhe Çikatovë të Vjetër të Drenasit...*, f. 495-503.

⁵⁰ *Fjalori enciklopedik i Kosovës...*, f. 1060.

⁵¹ Argjiira Ukimeri, *Masakra e Korishës*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 563-575.

⁵² *Fjalori enciklopedik i Kosovës...*, f. 1062; Hilmi Saraçi, *Masakra serbe në qytetin e Vushtrrisë (1998-1999)*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 586-607.

kampin e përqendrimit në Dubravë afër Istogut është planifikuar nga pushtuesi serb.⁵³

Regjimi serb i Beogradit ka intensifikuar sulmet kundër popullatës civile shqiptare në të gjitha mjediset ku jetonte. Më 14 maj 1999, forcat ushtarake e policore serbe sulmuan fshatrat Qyshk, Zahaq dhe Pavlan të Pejës, ku vranë 73 shqiptarë: në Qyshk – 43, në Zahaq – 20 dhe Pavlan – 9 banorë, në mesin e tyre edhe dy femra. Kufomat e të ekzekutuarve në Zahaq gjatë natës janë dërguar në drejtim të panjohur dhe kështu deri më sot disa prej tyre figurojnë në listën e të pagjeturve. Piromanët serbë bënë krime monstruoze dhe të papara mbi popullatën civile në fshatin Qyshk. Pasi kishin ndarë banorët shqiptarë në tri grupe, i kishin futur në tri shtëpi, të cilët, pasi i kishin vranë me automatikë, për të humbur gjurmë, ua kishin vënë flakën kufomave.⁵⁴

Më 9 qershor 1999, forcat ushtarake e policore serbe kanë ekzekutuar 31 banorë shqiptarë të lagjeve “Ibri” dhe “7 shtatori” në Mitrovicë. Masakra mbi civilët shqiptarë ishte bërë në shenjë hakmarrjeje për shkak të humbjeve që kishin pësuar forcat serbe nga NATO dhe UÇK-ja.⁵⁵ Gjatë periudhës 1989-1999, forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe kanë bërë krime e masakra edhe në malësinë e Gallapit të Prishtinës. Kështu, kanë vranë 27 dhe plagosur 8 banorë të Prapashticës, 6 banorë të Keqekollës, 4 banorë të fshatit Nishec, 4 banorë të Ballabanit; 22 banorë civilë të fshatit Koliq, 8 banorë të fshatit Sharban; 10 banorë të fshatit Rimanishtë; 2 banorë të fshatit Radashec; 1 banor i Hajkobillës në masakrën e Slllovisë; 5 banorë të Dabishefcit; 2 banorë të Glllogovicës; 9 banorë të Mramurit; 8 banorë të Busisë; 17 banorë të Grashticës; 3 banorë të fshatit Llukar; 8 banorë të Makocit; 2 banorë të Kolovicës; 8 banorë të fshatit Siçevë; 5 banorë të Sofalisë; 10 banorë të Bërnicës; 5 banorë të Zllatarit; 2 banorë të Hajvalisë; 78 banorë të fshatit Marec.⁵⁶ Shumë të vranë sot gjenden në varreza masive në vende të ndryshme të Serbisë e gjetiu. Meqë pushteti serb as sot nuk pranon krimet gjenocidin që ka bërë, përpiqet vazhdimisht të fshehë gjurmët e krimit, pra edhe të mos i identifikojë varrezat masive. Kështu, mbi 11 000 të vranë konsiderohen të zhdukur: në komunën e Prizrent - 103, në komunën e Gjilanit - 12, në komunën e

⁵³ *Fjalori enciklopedik i Kosovës...*, f. 1053-1054; Kristinë Oroshi, Masakra e burgut të Dubravës (19-24 maj 1999, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 608-615.

⁵⁴ *Fjalori enciklopedik i Kosovës...*, f. 1058, 1062

⁵⁵ Po aty, f. 1063-1064.

⁵⁶ Murat Ajvazi, *Masakrat serbe në Malësinë e Gallapit të Prishtinës*, botuar në “Masakrat dhe krimet serbe, malazeze dhe të tjerëve në trojet shqiptare (1945-1999)” II, Prizren, 2023, f. 510-534.

Vushtrrisë - 23, në komunën e Podujevës - 41, në komunën e Dragashit - 1, në komunën e Kaçanikut - 12, në komunën e Ferizaj 13, në komunën e Lipjanit 8, në komunën e Kamenicës - 1, në komunën e Suharekës - 89, në komunën e Leposaviqit - 1, në komunën e Mitrovicës - 146 (kanë qenë 279), në komunën e Zubin Potokut - 5, në komunën e Istogut - 29, në komunën e Gjakovës - 96, në komunën e Deçanit 96, në komunën e Pejës - 92, në komunën e Shtimes - 10, në komunën e Shtërpcës - 1, në komunën e Zveçanit - 2, në Ranillug - 1, në komunën e Klinës - 93, në komunën e Skënderajt - 101, në komunën e Obiliqit - 13, në komunën e Drenasit - 39 etj.

Gjenocidin nuk e bën të tillë vetëm numri i të vrarëve, por motivi, karakteri dhe qëllimi i tij

Një gjenocid nuk e bën të tillë vetëm numri (sasia) i viktimave (të vrarëve), por motivi, karakteri dhe qëllimi i tij. Në këtë pikëpamje, krimet që kanë ndodhur që nga viti 1988/89 e deri në përfundim të luftës në Kosovë (qershor 1999): suspendimi i autonomisë së Kosovës, vrasja e ushtarëve shqiptarë në APJ, demonstratat ku shqiptarët shprehnin pakënaqësinë e tyre, izolimi i 237 intelektualëve, Greva e Minatorëve, segregacioni e helmimi i nxënësve, dëbimi i punëtorëve shqiptarë nga vendet e punës, kërcënimet e përjashtimet e mjekëve nga puna të akuzuar për komplete, goditjet e provokimet ndaj simboleve kombëtare shqiptare, cenimi dhe masakrimi i kultit të figurave kombëtare dhe të traditave kombëtare (Skënderbeu, Luigj Gurakuqi, Bajram Curri, Hasan Prishtina etj.), heqja e gjuhës shqipe nga vultat e administrata, ndërrimi i emrave të rrugëve e institucioneve, emërimi i drejtorëve të dhunshëm serbë, burgosjet politike (mbi 100 sish në komunat: Mitrovicë, Vushtri, Skënderaj e Drenas), në mesin e tyre edhe udhëheqësit e Kombinatit “Trepça”, Aziz Abrashi, Burhan Kavaja, Ibush Jonuzi etj., pastaj mësimdhënës të dalluar etj. e deri në përfundim të shek. XX (1999), nuk dallojnë nga ato që kanë ndodhur gjatë pastrimit etnik në sanxhakun e Nishit, nga krimet në vitin 1912-1913, pastaj gjatë periudhës midis dy luftërave botërore, pas përfundimit të LDB-së dhe instalimit të pushtetit komunist, gjatë aksionit të mbledhjes së armëve (1956), gjatë demonstratave të viteve 1968 e 1981 etj. Që nga përfundimi i LDB-së dhe formimi i Jugosllavisë Socialiste, ku për shqiptarët dhe për popujt e tjerë ka qenë i detyruar shërbimi ushtarak, shumë të rinj janë kthyer në arkivole, ku, në shumicën e rasteve, familjarëve u është shpjeguar se kanë bërë vetëvrasje. Që nga viti 1989–1999, jeta e ushtarëve shqiptarë në Federatën jugosllave bëhej gjithnjë e më e pasigurt. Shumica prej tyre shërbenin jashtë Kosovës: në Serbi, Maqedoni, Slloveni, Kroaci, në

Bosnjë-Hercegovinë e në Mal të Zi. Ushtarët shqiptarë në ushtri konsideroheshin si qytetarë të rendit të tretë a të katërt. Ata keqtrajtoheshin në mënyrën më të ashpër e të egër. Ata që nuk e zotëronin serbishten “gjuhën e shtetit”, quheshin armiq, nacionalistë etj. Në fillim të viteve ‘90 të rinjtë shqiptarë në Armatën jugosllave janë përdorur si mish për top në luftërat në Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë, kështu vetëm që nga viti 1989 janë vrarë 23 ushtarë: Qamil Ramadan Thaçi (Gjakovë), Halim Shaqir Lita (Klinë), Xhavit Alush Berisha (Prishtinë), Izet Ismajli (Vushtrri); Vahedin Xhemshit Hajrizi (Dragash), Hamit Jahë Haxhiu (Gjakovë), Jetullah Haxhi Desku (Klinë), Halim Halil Gashi (Lipjan), Xhevdet Hajredin Aruçi (Skënderaj), Fatmir Adem Tafaj (Suharekë), Muhamet Tahir Osmani (Podujevë), Xhevdet Pomak (Dragash), Agim Salih Gllareva (Drenas), Lulzim Faik Rexhepi (Drenas), Tahir Azem Gashi (Drenas), Ali Nazif Sahiti (Ferizaj), Muharrem Faik Muharremi (Ferizaj), Faik Islam Kashtanjeva (Ferizaj), Abedin Sahit Krasniqi (Fushë-Kosovë), Ejup Esat Gashi (Fushë-Kosovë), Setar Mustafë Ramadani (Gjakovë), Vesel Dan Duraku (Gjakovë), Fadil Xhabir Salihu (Gjilan); Agim Gllareva (Vërovç, 1971) është marrë me dhunë në APJ (1990), ka shërbyer në garnizonin e Kërçovës (Maqedoni), mirëpo pas shpërthimit të luftës, është dërguar në frontin e luftës në Slloveni, ku është vrarë më 14 tetor 1991. Po kështu në APJ është vrarë edhe Tahir Gashi, i cili ka shërbyer në Osjek të Kroacisë.

Për fat të keq, përkujtimi i masakrave në Kosovë dhe në hapësirat tjera shqiptare që po bëhen pas luftës deri më sot, shpesh kalojnë si ngjarje lokale. Prandaj për këtë arsye duhet të mobilizohemi edhe më mirë në mënyrë që të bëjmë diçka më shumë në sensibilizimin ndërkombëtar të këtyre krimeve që i ka bërë Serbia në vazhdimësi, sidomos në dhjetëvjetëshin e fundit të shek. XX. Kjo ka rëndësi jo vetëm për shkencën shqiptare, si problem që lidhet me rrënjët e së keqes, por edhe me atë ballkanike, evropiane e më gjerë, sepse mosmarrëveshjet vazhdojnë dhe mundësitë për t’u rishfaqur a ripërtërirë konfliktet e gjakderdhjet janë shumë të mundshme, madje, të thuash, në çdo kohë. Trajtimi i shumanshëm dhe kompleks i problemit të krimeve, masakrave dhe gjenocidit që janë bërë nga serbët ka qenë qëllim parësor imi. Në analizën dhe sintezën e thelluar të fakteve e të ngjarjeve, jam përpjekur të vlerësoj drejt ndërthurjen e faktorëve të brendshëm e të jashtëm, duke u mbështetur në burimet e shkruara e të pashkruara, të cilat i kam shfrytëzuar me sy kritik. Gjithashtu dëshiroj të theksoj se, për të mbarështuar këtë kumtesë timen, kam shfrytëzuar në mënyrë të gjerë burime të ndryshme, si kujtesën popullore, burime e materiale të reja vendase etj. Kjo më ka ndihmuar që të mënjanoj njëtrajshmërinë në trajtimin e kësaj çështjeje dhe të mbush disa zbrazëti të

krijuara nga mungesa e dokumenteve historike. Ato të gjitha, mendoj, i bashkon një lidhje organike që i shërbejnë qëllimit të vetëm shkencor.

Serbia edhe sot vazhdon të përpiqet ta zhveshë popullin shqiptar nga traditat e mëdha nacionale, të mohojë rolin aktiv pozitiv të faktorëve etnikë, duke mohuar krimet që ka bërë, madje edhe këto të fundit në vitet '90, që kulmuan me vrasje masive, masakra, dhunë e terror, gjenocid⁵⁷ gjë që e detyroi botën demokratike të ndërhyjë, duke goditur caqet ushtarake e policore serbe derisa e detyruan të kapitullojë. Historiografia jonë vazhdon të ndeshet me pikëpamjet tendencioze antishkencore dhe shoviniste serbe që, për qëllime politike antishqiptare, në kundërshtim me faktet historike e duke i shtrembëruar ato, mohojnë jo vetëm autoktoninë, vazhdimësinë iliro-shqiptare në trojet e veta historike, por edhe të gjitha ato masakra, pra gjenocidin që ka bërë në këto hapësira gjatë viteve 1989-1999. Regjimi i Beogradit i quante shqiptarët armiq, kundërrevolucionarë, separatistë, kriminelë etj., për të justifikuar këto krime makabre para opinionit ndërkombëtar, Serbia ka trilluar gjithmonë fabula të ndryshme. Madje edhe krimet e fundit ndaj fëmijëve, grave e pleqve Serbia i ka përligjur, duke u arsyetuar se ato janë bërë në luftë me terroristët e UÇK-së, apo se janë viktimat të bombardimeve të NATO-s. Kjo ka qenë filozofia, strategjia dhe praktika e Serbisë e krimit që ishte ngritur në sistem.

⁵⁷ Gjenocid - dhunë e egër shfarosëse e një populli apo grupeve të veçanta kombëtare që bëhet nga qeveria shoviniste-fashiste. Gjenocid quhet secili nga aktet që kryhen me qëllim të asgjësimit plotësisht ose pjesërisht të një grupi kombëtar, etik, racial ose fetar. Dhunë - përdorim i shtrengimit fizik ose politik, i mjeteve e metodave të vrazhda ndaj dikujt për ta detyruar të bëjë diçka jashtë vullnetit të tij, për ta nënshtruar, për ta shtypur etj. Terror - dhunë e egër që zbaton një regjim shtypës ndaj një populli apo ndaj kundërshtarëve. Asimilim - përpjekja për ta shuar një popull a një komb, duke bërë të humbasë veçoritë e tij kombëtare dhe të marrë gjuhën, zakonet etj., të një kombi a të një populli tjetër.

